



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:103420

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05437579

CP.nr.06/2014

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Fuad Haliti dhe me bashkëpunëtorin profesional Eron Prekazi, në çështjen përmbarimore CP.nr.06/2014, të kreditorit Ndërmarrja “Dardafon.Net” Sh.P.K. me seli në Miradi të Epërme, komuna e Fushë Kosovës, të cilën e përfaqëson Valon Basha, këshilltar ligjor, kundër debitorit D.B me banim në Mitrovicë, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej 217.60 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 12.03.2024 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

Propozimi për përmbarim i kreditorit Ndërmarrja “Dardafon.Net” Sh.P.K, me seli në Miradi të Epërme, komuna e Fushë Kosovës, ndaj debitorit D.B me banim në Mitrovicë, konsiderohet se është TËRHEQUR, meqenëse kreditori nuk ka vepruar konform udhëzimeve të dhëna me konkluzionin CP.nr.06/2014 të datës 15.01.2016.

Arsyetim

Kreditori, Ndërmarrja “Dardafon.Net” Sh.P.K, me seli në Miradi të Epërme, komuna e Fushë Kosovës, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit kundër debitorit D.B me banim në Mitrovicë, për pagesën e borxhit në lartësi prej 217.60, në afat 7 ditor në të kundërtën, të bllokohen llogaritë bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjete në llogari të bëhet regjistrimi, sekuestrimi, vlerësimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të pa luajtshme e mjetet e mbledhura të derdhen në llogari të kreditorit.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktvendimin CP.nr.06/2014, ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoi se mungon adresa e debitorit, andaj, Gjykata në lidhje me këtë çështje e urdhëron kreditorin me konkluzionin CP.nr.06/2014 të datës 15.01.2016, që në afat prej 7 ditësh, kësaj Gjykate t’i siguroj adresën e debitorit, e nëse nuk veprohet sipas udhëzimeve në konkluzion, gjykata do propozimin për përmbarim do ta

konsideroj se është tërhequr, po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e ne qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësia do të hidhet poshtë.

Kreditori me datë 19.01.2016 e ka pranuar konkluzionin në fjalë, mirëpo në afatin e paraparë prej 7 dite, nga shkresat e lëndës rezulton se i njëjti nuk ka vepruar sipas asaj që i është kërkuar me konkluzion.

Andaj, Gjykata duke e marrë parasysh se kreditori nuk veproi sipas konkluzionit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u mbështetur në normën e nenit 17 të LPP, e në lidhje me nenin 102 paragrafi 3 të LPK.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
CP.nr.06/2014, me datë 12.03.2024

GJYQTARI
Fuad Haliti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, brenda afatit prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të njëjtit, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.